

## përmbajtja

- 2 Akcioni Humanitar "Përcjell zembrën tënde" dhuron kuzhinë për "Dera e Hapur"
- 2 RrGGK merr pjesë në Seminarin Ndërkombëtar
- 3 Siguria fillon në shtëpi – Ndikimi në Ligj
- 3 "Zëri i Votuesve" publikon raportin e dytë
- 3 Është themeluar Rrjeti i Grupeve të Grave Serbe të Kosovës
- 4 RrGGK Publikon Botimin e dytë të Raportit Monitorues për Implementimin e RKSKB 1325
- 4 NORMA rreth Ligjit mbi Barazinë Gjinore dhe të Drejtat e Trashëgimisë për Gratë

## njoftimet

Mbledhja e Anëtareve të RrGGK-së  
**7 Shtator**  
**ora 11:00**



Nga Flaka Surroi

## Luftëtari për Barazi

E kisha takuar për herë të parë para 15 vjetësh. Atëherë, kishte mbi pesëmbëdhjetë vjet qëkur ishte lidhur për karrocën e invalidëve pas një aksidenti të rëndë trafiku, të cilin e kishte mbijetuar. Siç e përshkruante ai, kishte qenë çasti në të cilin e gjithë jeta e tij ishte thyer – karriera e suksesshme prej inxhinieri, perspektiva e një të riu që ende nuk i kishte mbushur të tridhjetat dhe të gjitha ëndrrat dhe planet, iu bënë copë e grimë në çastin kur i kishin thënë se më nuk do të mund të ecte në këmbët e veta.

Ata që e kishin njohur më gjatë se unë, flisnin me admirim për mënyrën se si e kishte nxjerrë veten nga depresioni i rëndë, të cilin ia kishin shkakuar sekondat e shpërqendrim-it gjatë ngasjes së veturës. Më tregonin se si, me ndihmën e të afërmeve, i kishte përshtatur që të gjitha orënditë në shtëpi, ashtu që do të mund t'i mbërrinte vetë, teksa me lëvizje prej artisti, manipulonte me karrocën e tij. Kishte mësuar të gatuar, të lante e të pas-tronte – e që të mos kishte nevojë të kërkonte ndihmë nga të tjerët. Me të drejtë thoshte: "Nëse jam i paaftë të eci, nuk jam i paaftë t'i bëj të gjitha të tjerat, përderisa ende më punon truri". Dhe nga ai mësova se njerëzit që kishin fatin e keq të mos mundnin t'i lëviznin gjymtyrët për shkak të aksidentit apo sëmurjes nuk ishin persona me paaftësi, por ishin persona me aftësi të kufizuara.

Ditën që e takova, para se të dilnim së bashku në terren, na erdhi në takim në "Mazdën" e vet të kuqe. E parkoi veturën me përvojën e gjatë të një shoferi të mirë. E hapi derën, e nxori karrocën nga ulësja e

përparme dhe e vendosi para derës për ta bartur trupin e tij në të. Këmbët i tërhoqi dhe i vendosi mbi mbështetëset e poshtme të karrocës, u largua pak nga vetura sa për ta mbyllur derën me çelës. U kthye nga ne dhe na përshëndeti të gjithëve me tenorin e tij të bukur dhe me buzëqeshjen, e cila ia eliminonte vrazhdësinë e mustaqeve të trasha, të cilat kishin filluar t'i thinjeshin nga pak. Mbase i mësuar që ta pyesnin – na parapriu me rrëfimin se si kishte vendosur ta thyente frikën e të vendoste ta ngiste veturën sërish. "E dija se nëse arrija ta shëroja këtë traumë, mund të arrija çfarëdo tjetër që do të mund të synoja. Kur mësova ta ngas veturën vetëm me duar, kuptova se, me pak ndihmë, mund të arrija t'u bëja ballë të gjitha pengesave në jetë. E njerëzit si unë, e dinë më mirë se kush tjetër se sa të mëdha mund të duken këto barriera".

E kishte themeluar Shoqatën e Paraplegjikëve dhe e kishte një zyrë të vogël në lagjen "Dardania". I kishte dy a tre miq që i ndihmonin në përpjekjet për t'u ndihmuar atyre që e gjithë shoqëria i kishte harruar. Pati fatin të takohej me udhëheqësit e shoqatës "Nëna Terezë" e sidomos me udhëheqësit e Shërbimit Shëndetësor të kësaj shoqate. Në mos tjetër, tash kishte kush t'ia hapte derën e bile ta pyeste se si ndihej. Falë këtij kontakti u bë që atë ditë dolëm në terren së bashku. Meqë nuk fliste anglisht, komunikonte me donatorët potencialë nëpërmjet përkthyesit. Por e kishte një



përparësi shumë të madhe në komunikim – lutjen për ndihmë që po e bënte e kishte shumë qartë të zbrëthyer në tri pika kryesore. Kërkonte që t'i ndihmonin ta krijonte një bazë të shënimeve të të gjithë personave me paaftësi, pavarësisht llojit; të bënte një strukturim rajonal të qendrave që do t'u ofronin kujdes këtyre njerëzve dhe njëkohësisht ta zbrëthente listën e pajisjeve bazike që do t'u nevojiteshin këtyre personave për t'i aftësuar që të bëheshin të pavarur si ai.

Gjatë përpjekjeve të vetmuara, kishte arritur t'i identifikonte disa nga personat që kishin nevojë për përkrahje. Me ndihmën e miqve, ndonjëherë e siguronte ndonjë karrocë dhe e dërgonte në terren. Atë ditë, kishte marrë një me vete. "Për çdo rast, ta kemi", më tha. Shkuam në një fshat të Skenderajt. Më luti t'ia mba-ja fort karrocën derisa prej xhipit e lëshonte trupin në të. Për më tepër, më nderoi kur më lejoi t'ia shtyja karrocën përpjetë – e refuzonte ndihmën edhe për shkak se duhej t'i ushtronte krahët dhe duart dhe të mos lejonte që

## Akzioni Humanitar "Përcjell zembrën tënde" dhuron kuzhinë për "Dera e Hapur"

Qendra e gruas "Dera e Hapur" në Prishtinë, 31 mars 2009 pranoi donacionin nga Industria e Ushqimit Podravka nga Koprivnica, Kroaci.

Ky donacion është e bazuar në fushatën humanitare të Podravkes "Përcjell zembrën tënde" e cila është organizuar duke filluar nga 15 dhjetor 2008 deri me 15 janar 2009, në ueb faqen Coolinarika.com, ndërsa pajisjet e vlefshme të kuzhinës në emër të Podravkes, udhëheqëses së kësaj organizate Belgjyze Muharremi, ia dorëzoi Z. David Habijan, Drejtori për Marketing i Podravkes në Kosovë.

Përveç organizatës Dera e Hapur në Prishtinë, aparate të kuzhines Podravka i ka dhuruar edhe Shtepise së Sigurte në Vukovar të Kroacisë, SOS fshatit të fëmijëve Sarajevë në Bosnje dhe Hercegovinë, Oaza e sigurisë Kragujevc në Serbi, Shtëpisë së fëmijëve Mladost nga Mali i Zi dhe Krizen Centar Nadez - Shkup në Maqedoni.

Përmes këtyre aktiviteteve në Coolinarika duke shtuar rreth 1 500 receta, rreth 12 500 fotografi dhe më tepër se 56 000 komente dhe afër 18 000 shkrime në këtë forum, ata kanë kontribuar në përbushjen e qëllimit të aksionit – dhurimi i atyre të cilëve i është më e nevojshme. Të gjitha këto aktivitete kanë mbushur zembrën e madhe të mirësisë në faqen e parë të Coolinarikës deri te arritja e qëllimit, e ai është të mblidhen 100 000 zemra.

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)

### vazhdon nga fq.1

edhe ato të atrofionin. Për të njëjtin shkak ishte kundërshtar i fuqishëm i karrocave me motor, pos në rastet kur nuk kishte rrugëdalje tjetër. Teksa ngjiteshim kodrës iu afruam një shtëpie. Nja katër a pesë fëmijë po luanin në oborr. Një vajzë, atëherë dymbëdhjetë vjeçe, po rrinte e ulur pranë dritares. Fytyra i rrezatonte pikëllim. Kishte kohë që këmbët kishin filluar ta humbnin fuqinë dhe ia pamundësonin shkuarjen në shkollë për çdo ditë. Ishte nxënësja më e mirë e shkollës. Tash po e humbte gëzimin e vetëm që i kishte mbetur.

Ai e vërejti i pari. Më kërkoi që të mos i ndihmoja më. Duke i shtyrë rrotat, iu afrua dritares dhe e nisi bisedën me vajzën. Teksa shtoheshin të qeshurat e tij, fytyra e vajzës po merrte shkëlqim të ri, ndërsa sytë filluan t'i vezulonin ndryshe, duke e mbajtur gëzimin të fshehur nën hijen e lotit. Fëmijët e ndalën lojën, kurse dy syresh u futën në shtëpi. Me ngadalë, vajza filloi të largohej nga dritarja, kurse ai m'u kthye e më luti që t'ia sillja karrocën nga vetura, të cilën e kishim marrë "për çdo rast". Vajza doli e mbështetur mbi supet e vëllezërve të saj dhe iu afrua atij, i cili tashmë e kishte shpalosur karrocën dhe na demonstronte se si duhej fiksuar që të qëndronte stabil. "Tash nuk ke arsye të mos shkosh në shkollë", i tha ai. E mahnitur, vajza u ul duke u kthyer nga ai dhe duke e

pyetur pa pra: "A përnjëmend, axhë? A përnjëmend po ma fal?".

Halit Ferizi e kishte përnjëmend. Vajza vazhdoi ta vijonte mësimin falë shoqeve e shokëve që e ndihmonin të lëvizte me karrocën që ia kishte falur, nëpër terrenin e parregullt. Por më e çmueshmja nuk ishte karroca. Ishte vetë Haliti – sinonimi i shpresës. I të mundurës. Me shembullin që po e jepte dhe me porosinë që po ua përcillte njerëzve që kishin nevoja të veçanta – se nuk duhej dorëzuar. Haliti, i cili e mësoi anglishten në krye të dy vjetëve pas kësaj vizite. Haliti me zembrën e tij të madhe, me fuqinë emocionale, me mendjen e ndritur, me rrëzimin e të gjitha barrierave, me thyerjen e tabuve...

Vdekja e hershme e Halitit

është humbja e një njeriu të madh që më së shumti do t'i godasë njerëzit, për të cilët punoi me dekada, sepse Haliti me punën e tij dhe ndihmën e bashkëpunëtorëve, ua ofroi personave me aftësi të kufizuara atë që institucionet, që e kanë për obligim, nuk u dhanë. Neglizhencë, e cila u reflektua edhe në komemoracionin e djeshëm, i cili u mbajt pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë – një ofendim, të cilin as Haliti e as personat me aftësi të kufizuara nuk e kanë merituar. Dhe, i cili nuk do të lahet as me çfarëdo mirënjohje të vonuar.

Fatmirësisht, ishin të shumtë ata, të cilët në vend të mirënjohjes, sollën me vete ndjenjat e sinqerta për ta nderuar kujtimin për Halit Ferizin, luftëtarin e vërtetë për barazi.



## RrGGK merr pjesë në Seminarin Ndërkombëtar

Më 7 dhe 8 mars, anëtarja e bordit të RrGGK-së dhe Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës për Trajnime dhe Studime Gjimore, Arjeta Rexhaj, mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar mbi Fuqizimin e Grave, Zhvillimin e Leadershipit, Paqen dhe Sigurinë Ndërkombëtare në Monrovia, Liberi të udhëhequr nga presidentet Ellen Johnson Sirleaf e Liberisë dhe Tarja Halonen e Finlandës. Seminari mblodhi së bashku me qindra aktiviste dhe zyrtarë qeveritarë nga tërë bota

për të diskutuar për fuqizimin e grave në arenat politike, ekonomike dhe sociale.

Aktivistet u mblodhën për të ndarë përvojat e tyre dhe për të mësuar nga ato të tjerëve mbi temat si roli i grave në leadership, dhunën në baza gjinore, zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB-së 1325, Qëllimi #3 për Zhvillim të Mileniumit mbi promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, efekti i krizës ekonomike globale mbi gratë, statusi seksual dhe riprodhues i grave, ndërrimet kli-

matike dhe migrimi.

Pika kulmore e ngjarjes ishte miratimi i Deklaratës së Monrovia më 8 mars, Dita Ndërkombëtare e Grave e emëruar nga KB-ja. Seminari gjithashtu themeloi një mekanizëm për qëndrueshmërinë e punës së saj me krijimin e Qendrës Ndërkombëtare Angie Brooks mbi Fuqizimin e Grave, Zhvillimin e Leadershipit, Paqen dhe Sigurinë Ndërkombëtare.



## Siguria fillon në shtëpi – Ndikimi në Ligj

Në mars 2008, qeveria e Kosovës ka aprovuar Programin për Barazi Gjinore në Kosovë (2008-2013). Programi, i cili është hartuar nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), kërkon krijimin e mekanizmave ligjor të domosdoshëm për mbrojtje kundër dhunës në familjare dhe dhunës ndaj grave. Në përgatitjen e hartimit të Ligjit mbi Dhunën Familjare, ABGj dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës kanë punuar së bashku, me përkrahje të projektit të UNDP-së, Iniciativa për Siguri dhe Mbrojtje të Grave (WSSI), për të bërë hulumtime gjithëpërfshirëse mbi dhunën familjare. Hulumtimi rezultues është publikuar në raportin Siguria Fillon në Shtëpi: Hulumtim për të informuar Strategjinë e parë dhe Planin Veprues Nacional kundër Dhunës Familjare në Kosovë. Raporti ka bërë një observim befasues: 46.4% të të gjithë respondentëve gra të anketës kanë deklaruar se kanë përjetuar dhunë në familjet e tyre.

Me krijimin e e kësaj kornize të nevojshme për politika dhe analiza, hartimi i Ligjit mbi Dhunën në Familje (LDhF) është futur në strategjinë vjetore legjislativë të qeverisë. Grupi punues ndër-ministral është formuar në mars 2009 dhe ka përgatitur hartimin e

parë të LDhF. Grupi Punues Qeveritar është formuar nga përfaqësues të të gjitha institucioneve relevante qeveritare (ministritë dhe agjencitë), shoqërisë civile (OJQ-të dhe strehimoret), anëtarë të sistemit juridik (gjykatës, prokuror), dhe agjencitë ndërkombëtare (EULEX, OSBE, UNIFEM). Ky grup punues prej 20 anëtarëve është mbledhur në katër seanca, përderisa dy seanca shtesë gjithashtu janë organizuar me pjesëmarrjen e mbi 30 përfaqësuesve të shoqërisë civile, dhe organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare. Hartimi i ligjit është komentuar dhe hartuar gjatë një periudhe katër mujore dhe për momentin është duke u komentuar nga Agjencia për Integritet Evropian. Me përkrahjen e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-ve IC-ITAP, versioni në gjuhën angleze i LDhF gjithashtu është redaktuar dhe komentuar. UNDP – WSSI ka përkrahur gjithë procesin në rolin teknik dhe këshillëdhënës, përfshi përkrahjen përmes këshilltarit ekspert. Në përgjithësi, hartimi i LDhF është vlerësuar si procesi me më së shumti pjesëmarrje, dhe kjo kontribuon në sigurimin e praktikave demokratike në reformën legjislativë.

Nga korriku e deri në tetor 2009, UNDP – WSSI gjithashtu do të përkrahë një studim kualitativ mbi Reagimin e Ofruesve të Drejtësisë ndaj Dhunës në Familje me qëllim të përkrahjes së qeverisë së Kosovës dhe politkëbërësit në përgatitjen dhe implementimin e mekanizmave të ardhshëm (Plani Veprues Nacional kundër Dhunës në Familje dhe LDhF). Ky hulumtim gjithashtu do të ndihmojë akterët e shoqërisë civile që të kuptojnë më mirë ambientin ekzistues ligjor në Kosovë në lidhje me dhunën në familje, përfshi pjesëmarrjen e tyre rrjetin monitorues dhe verifikues të shoqërisë civile që do të përkrahët nga UNDP - WSSI. Këto tri dokumente dhe mekanizma do të ofrojnë një kornizë të rëndësishme për matjen e suksesit dhe pengesave për institucionet dhe shoqërinë civile në adresimin e çështjeve më të gjëra të dhunës në familje. UNDP - WSSI gjithashtu do të vazhdojë përkrahjen për strehimoret nëpër Kosovë dhe zhvillimin e strukturave afatgjata të qëndrueshme të monitorimit dhe verifikimit të shoqërisë civile në Kosovë. Kjo e fundit do të jetë posaçërisht relevante drejt implementimit të LDhF, përfshi mandatin dhe përgjegjësitë që parashihen.

## "Zëri i Votuesve" publikon raportin e dytë

Më 17 Prill në Hotel Grand, RrGGK bëri publikimin e raportit të fundit të projektit "Zëri i Votuesve". Në praninë e gazetarëve, hapjen e kësaj ngjarjeje e bëri Ambasadori i Zyrës së Mbretërive të Bashkuar, i cili falenderoi dhe uroi RrGGK-në për punën e bërë.

Të dhënat e dala nga ky raport i prezantoi Iqbal Rogova, drejtoreshë ekzekutive e RrGGK-së. Ndër shqetësimet më kryesore të qytetarëve të Kosovës me të drejtë vote ishin: reduktimet e rrymës, rrugët e pa asfaltuara, korrupsioni, papunësia, reduktimet e ujit, varfëria, sisteme jo adekuate të ujësjellesve, shërbimet jo cilësore shëndetësore si dhe ndotja e ambientit. Në

raport janë përfshirë 1052 thirrje në linjën telefonike, e cila është pa pagesë në shërbim të qytetarëve (0800 201 401), gjithashtu janë përfshirë ankesat e pranuar në e-mail a d r e s e n zerivotuesve@gmail.com si dhe nga takimet e mbajtura në tetë komuna të Kosovës. Për të argumentuar shqetësimin ndaj shërbimeve të mangëta shëndetësore, një qytetar thotë: "Sistemi shëndetësor nuk funksionon siç do të duhej, sepse shërbyesit civil, mjekët, janë duke përfutur në biznes", qytetari vazhdon: E di nga përvoja personale se menaxhmenti i Klinikës Neurologjike dërgon pacientët nga spitali publik në klinikat e tyre private për të bërë inqizimet

CT, ku qytetarët paguajnë 35 euro dhe funksionin siq duhet". Raporti përfshin ankesat e qytetarëve nga 28 komuna, prej 35 sa ka gjithsejt Kosova. Ankesat janë ndarë sipas komunave, dhe për secilën komunë janë parashtruar rekomandime varësisht prej nevojave të qytetarëve të asaj komune.

Raporti u është dorëzuar të gjithë deputetëve të Parlamentit, udhëheqësve të ministrive, Kryeministrit, kryetarëve të komunave si dhe ambasadave dhe zyreve ndërlidhëse në Kosovë.

Për më shumë të dhëna mbi raportin "Zëri i Votuesve" ju lutemi shikoni në [www.women-snetwork.org](http://www.women-snetwork.org).

## Është themeluar Rrjeti i Grupeve të Grave Serbe të Kosovës

Aktivistët për të drejta të grave serbe në Kosovë kanë ardhur në përfundim se puna e OJQ-ve serbe ka dështuar që të përfshijë zërat e grave dhe vajzave nga rrethet serbe që mendojnë se integrimi dhe një jetë më e mirë në Kosovë është domosdoshmëri. Ato kanë konkluduar se gratë nga komuniteti serb i takojnë një grupi mjaft sensitiv dhe nënshtrohen në luajtjen e një roli shumë pasiv në procesin e tranzicionit dhe demokratizimit. Përpjekjet e tyre të shumta për të sjellë përfshirjen e grave në proceset e mëtuqeshme kanë mbetur të pasuksesshme. Në pajtim me përvojën e tyre, dhe me qëllim të tërheqjes së përfshirjes së tyre në zhvillimet e përgjithshme të realitetit të ri në Kosovë, pesëmbëdhjetë OJQ janë bërë bashkë për të krijuar një rrjet të përbashkët, në partneritet dhe bashkëpunim me UNIFEM-in. Si rezultat i bashkëpunimit të gjatë në mes të OJQ-ve serbe, është themeluar Rrjeti i Grupeve të Grave Serbe të Kosovës (RrGGSK) si pjesë përbërëse e RrGGK. Gjatë majit, RrGGSK ka filluar procesin e regjistrimit, ka përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme, dhe është marrë vesh mbi strukturën funksionuese të rrjetit dhe misionin, vizionin dhe caqet strategjike të tij për vitin 2009. Misioni i RrGGSK është që të rrisë vetëdijen mbi të drejtat e grave, të fillojë aplikimin e plotë të rregulimeve ligjore që mbrojnë të drejtat e grave, përhapi kulturën e paqes, tolerancës, dialogut, bashkëpunimit dhe marrëveshjes në zgjedhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet. Rrjeti do të fillojë punën duke forcuar kapacitetet organizuese dhe duke krijuar mekanizmat e një rrjeti funksional.

## RrGGK Publikon Botimin e dytë të Raportit Monitorues për Implementimin e RKSKB 1325

### Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

info@womensnetwork.org

038 245 850

Hajdar Dushi C-2, II/8

10 000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

www.womensnetwork.org

### Stafi i RrGGK

#### Igballe Rogova

Drejtoreshë Ekzekutive  
igorogova@yahoo.com

#### Besa Shehu

Menaxhere e Financave  
besa\_shehu@yahoo.com

#### Alba Loxha

Menaxhere për Informim  
albaloxha@yahoo.com

#### Nicole Farnsworth

Këshilltare & Huluntuese  
nicole.farnsworth@gmail.com

#### Tiffany Ommundsen

Praktikante nga  
Advocacy Project

#### Stafi i Projekteve:

**Adelina Berisha**  
**Mimoza Gashi**

### Bordi i RrGGK

#### Belgjyzare Muharremi

Kryetare e Bordit

#### Ariana Qosaj - Mustafa

**Arjeta Rexhaj**  
**Behar Selimi**  
**Nazlije Bala**  
**Shukrije Gashi**  
**Veprora Shehu**

#### Bordi Këshillues:

**Besim M. Kajtazi**  
**Delina Fico**  
**Rachel Wareham**  
**Vjosa Dobruna**

"Zëri i Gruas Kosovare"  
është shkruar dhe diazjuar nga  
Alba Loxha,  
me ndihmën e  
Tiffany Ommundsen.

www.womensnetwork.org

RrGGK ka publikuar botimin e dytë "Monitorimi i Implementimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1325 në Kosovë" me 12 qershor 2009. Raporti fokusohet në çështjet e grave, paqes dhe sigurisë që nga publikimi i botimit të parë në vitin 2007. Është e rëndësishme të vërehet se, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008, qeveria e Kosovës e jo UNMIK-u është bërë përgjegjëse për implementimin e RKSKB UNSCR 1325.

Botimi i dytë "Monitorimi i Implementimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 në Kosovë" ofron një analizë gjithëpërfshirëse të implementimit të rezolutës dhe është i ndarë në dy pjesë gjithëpërfshirëse.

Pjesa e parë e raportit ofron një përmbledhje të institucioneve në Kosovë të cilat duhet të zbatojnë implementimin e rezolutës. Këtu përfshihen or-

ganizatata ndërkombëtare siç janë Forca e Kosovës e NATO-së (KFOR), Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), Policia Civile Ndërkombëtare (CIVPOL), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe Agjencitë e KB-ve për Zhvillim (UNDP), Gra (UNIFEM), Fëmijë (UNICEF) dhe Refugjat (UNHCR). Gjithashtu diskutohet për institucionet lokale, përfshi qeverinë e Kosovës, Kuvendin e Kosovës, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), Policia e Kosovës, sistemi juridik dhe kodi penal i Kosovës, dhe shoqëria civile në Kosovë.

Pjesa e dytë e raportit ofron një analizë kritike për progresin e implementimit të tri fushave kyçe të Rezolutës 1325 në Kosovë. Ato janë: përfshirja e grave në të gjitha proceset vendimmarrëse, përfshirja e perspektivës gjinore në proce-

durat trajnuese për policinë dhe njësitë ushtarake, dhe mbrojtja e të drejtave njerëzore të grave në fushat e arsimit, ekonomisë dhe lirisë nga dhuna. Gjithashtu adresohet mbrojtja e të drejtave të anëtareve gra të grupeve minoritare të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve në Kosovë.

Hartimi dhe publikimi i botimit të dytë të "Monitorimi i Implementimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 në Kosovë" si dhe gjetjet adekuate flasin për rëndësinë e vazhdueshme për avokim për përfshirjen e zërave të grave në arenën e paqes dhe sigurisë.

Ky raport i dedikohet kujtimit për Dr. Lynne Alice, juriste, profesoreshë dhe aktiviste për të drejtat e njeriut e cila ka përgatitur botimin e parë të raportit në bashkëpunim me RrGGK.

Për raportin e plotë vizitoni:  
www.womensnetwork.org.

## NORMA rreth Ligjit mbi Barazinë Gjinore dhe të Drejtat e Trashëgimisë për Gratë

Organizata dhe asociacioni i juristëve Norma, anëtare e RrGGK, ka përfunduar projektin për vlerësimin e implementimit të Ligjit mbi Barazinë Gjinore në lidhje me të drejtat e trashëgimisë për gratë.

Norma ka filluar projektin në dhjetor 2008 dhe ka kryer aktivitetet në të gjitha pesë qarqet e Kosovës gjatë dimrit dhe pranverës 2009. Juristet e Normës kanë kryer aktivitete monitoruese dhe huluntuese, duke vizituar gjykatat komunale dhe zyrat e regjistrimit për të mbledhur dokumentacion dhe fakte. Për më shumë, juristet e Normës janë takuar dhe kanë intervistuar gjykatës që merreshin me çështje të trashëgimisë. Këto intervista, së bashku me rishikimin e plotë të regjistrimit të gjykatave, kanë ofruar shënime në lidhje me përbërjen gjinore të rasteve të tilla, përfshi atë se kush ka të drejtë ligjore për të marrë trashëgiminë dhe kush në fakt ka

marrë trashëgiminë.

Në gjetjet e tyre, Norma ka raportuar se ligji mbi kërkesat rreth trashëgimisë ka ndryshuar, kështu që zyrat e regjistrimit nuk janë më të obliguara që të informojnë gjykatën për vdekjen në mënyrë që të fillohet procedura e trashëgimisë. Pasi që ligji më nuk e kërkon këtë, gjykata tash duhet të mbështetet në informatat e ofruara nga kërkuesit të cilët kanë filluar procedurën.

Në përgjithësi, Norma ka gjetur se vet sistemi ligjor mbron të drejtat e trashëgimisë për të gjithë, pa marrë parasysh gjininë. Sidoqoftë, organizata në fund vjen në përfundim se pabarazia gjinore brenda trashëgimisë ekziston. Përderisa ligji mbron të drejtat e grave mbi trashëgimi, tradita shpesh mban pabarazinë gjinore.

Norma ka përfunduar projektin e vet duke mbajtur një diskutim në tryezë të rrumbulla-

kët ku janë përfshirë përfaqësuesit e gjykatave komunale, zyrtarët nga të gjitha pesë qarqet e Kosovës, dhe përfaqësuesit e zyrtarëve të Ambasadës Mbretërore të Holandës, Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës, Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Qendrës për Studime Gjinore, Qendrës për Trajnime Gjinore, Entit Statistikor të Kosovës, UNIFEM, Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, Zyrës për Barazi Gjinore, dhe Komisionin Parlamentar për Barazi Gjinore. Në tryezën e rrumbullakët, Norma ka ofruar rekomandimet e saja për politikën, përfshi kërkesën që gjykatësit të sigurojnë që të gjithë ata që kanë të drejtë ligjore mbi trashëgiminë të jenë prezent gjatë procedurës ligjore, duke zvogëluar koston e dorëzimit të kërkesave për trashëgimi në gjykatë dhe avokimin për regjistrimin e pronës në emër të personit i cili në fakt mban të drejtat për atë pronë.